

**STATUT
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
BRAHIMI-13/Sh.P.K.**

Në Këtë statut :

Ligji është Ligji Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
Statuti është Statuti i Shoqërisë.

KREU I I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA, DHE ADRESA E FAQES SË INTERNETIT.

NENI 1

DATA E THEMELIMIT EMRI DHE THEMELUESIT

1 - Sot me datë **22.07.2019** (Njëzetëdy Korrik Dymijënëntëmbëdhjetë), ditë e Hënë, **Unë**, Themeluesi, **Imelda LIKA**, lindur me **26.10.1981** në Sohodoll/Dibër, banuese në fshatin Vajmëdhej/Njësia, Administrative/Muhur/Dibër", zotëruese e Kartës së Identitetit nr.personal/personal no.I16026074C, mbi bazën e Akitit të Themelimit të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë kam krijuar këtë **STATUT** për **SHOQËRINË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR** të emërtuar :

BRAHIMI-13/Sh.P.K. të pështatur sipas ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008,"Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, për të zhvilluar aktivitet tregtar në fusha të ndryshme.

Shoqëria është një person juridik shqiptar që ushtron aktivitet privat në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë menjëherë pas regjistrimit të saj sipas ligjit në QKR.(Qendra Kombëtare e Regjistrimit).

2 - Themeluese e shoqërisë jam Unë, **Imelda LIKA**, mbajtëse e dokumentit të identitetit nr.personal/personal no.I16026074C, aktualisht banuese banuese në fshatin Vajmëdhej/Njësia Administrative/Muhur/Dibër.

NENI 2

OBJEKTI I VEPRIMTARISË DO TË JETË :

Prodhimi dhe tregimi i materialit ngrohës (Pelet) duke përdorur lëndën drusore bio. Tregimi i materialit ngrohës (pellet) me shumicë dhe me pakicë brenda dhe jashtë vendit për llogari të vetë shoqërisë dhe të të tretëve. Shfrytëzimi i qëndrueshëm i pyjeve (drutë e zjarrit dhe lënda tjetër drusore). Tregimi i lëndës drusore dhe druve të zjarrit dhe transporti i tyre. Tregimi i mallrave ushqimore, industriale, elektrike, elektroshtëpiake. Tregimi produkteve bujqësore e blegtorale. Tregimi i pjesëve të këmbimi dhe mjeteve të përdorura etj. Prodhimi dhe tregimi i materialeve të ndërtimit, import-eksporti i tyre brenda dhe jashtë vendit për llogari të vetë shoqërisë dhe të të tretëve. Veprimtari në fushën e turizmit, hapje e agjensive turistike dhe operatorëve turistike. Në fushën e transportit të udhëtarëve brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria do të veprojë në fushën e ndërtimit, projektimit, si dhe në fushën inxhinjerike. Veprimtaria e shoqërisë do të shtrihet edhe në ndërtimin e komplekseve industriale, spitaleve, veprave sociale, ndërtesave administrative, apartamenteve të banimit, zyrave, qendrave të biznesit, fabrikave, punishteve etj. Veprimtaria e shoqërisë shtrihet edhe në ndërtimin e urave, rrugëve, rikonstruksione, kanalizimeve, kanaleve ujitëse, rikonstruksione fasadash etj. Spektri i punës përfshin planifikimin e përgjithshëm dhe ndërtimin e infrastrukturës, teknikës përmbrrojtjen e natyrës. Shoqëria bën planifikime të përgjithshme dhe të pjesëshme. Shoqëria do të synojë

Imelda LIKA



punime të inxhinierisë së mjedisit, punime strukturore speciale, shtresa dhe mbistruktura speciale, punime pastrimi liqenore dhe lumore. Zbatim i projekteve te rehabilitimit të përrrenjeve dhe lumenjve dhe pyllezime; Zbatim projektesh per mbrojtjen e tokës. Prodhim fidanesh dhe mbledhje e farave Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit te tij, ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane, puse e shpime për ujë. Veprimitari në shërbime etj. Veprimitari në fushën e transportit të mallrave brenda dhe jashtë vendit me mallra të vetë shoqërisë dhe të tretëve. Veprimitari në fushën e turizmit, investime në këtë fushë, hoteleri, fshat turistik, bar-bufe, restoran etj. N.q.se gjatë aktivitetit të shoqërisë për ndonjëren nga veprimitaritë specifike të cituara më sipër do të nevojitet leje përkatëse, shoqëria është e detyruar të paiset paraprakisht me këtë leje nga organi kompetent.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë mbi 15 vjet (Pa afat).

NENI 4

SELIA, ADRESA E FAQES SË INTERNETIT DHE ADRESA ELEKTRONIKE

Shoqëria e ka SELINË në qytetin PESHKOPI në adresën :

Peshkopi Dibër, Lagija "Tomin-ish SMT", Rruga "Rruga Ahmet bez Karasani", ndërtesa ish SMT Nr.2, Z.K. Nr.3605

Adresa e Fakes së Internetit të shoqërisë është.....

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është : *astritlika72@gmail.com*

KREU I II

KAPITALI I REGJISTRUAR

NENI 5

VLERA DHE PAGESA E KAPITALIT TË REGJISTRUAR

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është : **1000 Lek (Njëmijëlekë)**.

Pjesëmarrja e Ortakëve Themelues (Ortaku Themelues) në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e formuar tërësisht nga Ortakët Themelues (Ortaku Themelues) në masën 100% të vlerës së tij.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë përbhet nga kontributi i Ortakut Themelues dhe përbëhet nga kontributi në natyrë dhe kontributi në para në vlerën **1000 Lek (Njëmijëlekë)**.

Vlera totale e kapitalit të regjistruar (Vlera e paguar) është **1000 Lek (Njëmijëlekë)**.

Kontributet në Para do të paguhen plotësisht me kontributin e Ortakëve Themelues (Ortakut Themelues) që në momentin e regjistrimit fillestar.

Pagesat e kontributeve në Para kryhen në llogarinë Nr. _____ pranë degës së -BANK" - Peshkopi.

Kuota e zotërimit të kapitalit të shoqërisë është 100% .

Vlera totale e kapitalit të regjistruar (Vlera e paguar) është **1000 Lek (Njëmijëlekë)**.

Kapitali themeltar **prej 1000 Lek ndahet në 1 pjesë (kuotë)**, me vlerë nominale **prej 1000 Lek (Njëmijëlekë)** dhe Ortaku Themelues është zotëruar i **100% të kësaj kuote** të nënshkruar e të paguar.

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimitarisë ekonomike të shoqërisë do të administrohet nga Ortaku (Ortakët) Themelues. Një pjesë e këtij fitimi mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit tregtar. Shoqëria është e detyruar të shlyejë të gjitha detyrimet që ka ndaj shtetit dhe të tretëve.

2

Imelola Gjika
M. Gjika

NENI 6

ZMADHIMI DHE ZVOGLIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeme të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute, sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvoglimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte, që kerkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvoglimi i kapitalit i prek ortakët në të njejtën masë, ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqsojnë

NENI 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të një Shoqërisë më Përgjegjësi të Kufizuar e të drejtat që rrjedhim prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet :

- a) - kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) - shitblerjes
- c) - trashëgimisë
- ç) - dhurimit
- d) - çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie

KREU i III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

NENI 8

ORGANI VENDIMMARRËS

Asambleja e Ortakëve (**Ortaku Themelues**) është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve (Ortaku Themelues) është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të shoqërisë për çështjet e mëposhtme :

- 1) - përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- 2) - emërimin e shkarkimin e administratorëve
- 3) - emërimin e shkarkimin e likuidueve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 4) - përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në pikat 2 dhe 3 të këtij nenit.
- 5) - mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- 6) - miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- 7) - zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit.
- 8) - pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- 9) - përfaqsimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.
- 10) - riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 11) - miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblesë.
- 12) - çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjeter apo person i tretë.

3 *Imelola Lika*
JGJ

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i Ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithëshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 9

MËNYRA E THIRRJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHËSHME

Asambleja e Përgjithëshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur Asambleja e Përgjithëshme nuk është thirrur sipas pikes 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 10

KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithëshme mund të marrë vendime vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30% (tridhjetëpërqind) të kuotave.

Në rastin kur Asambleja e Përgjithëshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikes 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithëshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendor më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite

NENI 11

MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e Përgjithëshme vendos me $\frac{3}{4}$ (*tri të katërtat*) e votave të zotëruarve të kapitalit të ortakëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit të regjistruar, shpëndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithëshme (**Ortaku themelues**) vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) - përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë
- b) - emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- c) - emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar
- ç) - përcaktimin e shpërblimeve
- d) - mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- e) - perfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- f) - miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR-së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

4 *Jmelolu Lika*
[Signature]

NENI 12

PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithëshme merr vendim për :

- a) - vlerësimin e veprimtarisë së tij
- b) - shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij.
- c) - ngritjen e ndonjë padie ndaj tij nga shoqëria
- ç) - dhënen ose jo të përfitimeve të reja

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuar vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

NENI 13

ADMINISTRIMI

(1).Asambleja e Përgjithëshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.Afat i emërimit është 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritjeje.Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2).Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcatimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3 – Administrator i shoqërisë do të jetë Znj. Imelda LIKA.

Administratori qëndron në detyrë për një periudhë pesëvjeçare (5) me të drejtë ripërtëritje, duke filluar afatin e qëndrimit në detyrë që me datën 22.07.2019 deri me datën 22.07.2024

NENI 14

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

Administratorët (Administratori) kanë (ka) të drejtë e detyrohen(t) të :

- a) -Të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithëshme
- b)-Të përfaqësojnë shoqërinë tregtare
- c) -Të kujdesen (t) për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe librave kontabël të shoqërisë.
- ç) - Të përgatisin (së) dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqesin dokumentat përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim.
- d) - Të krijojnë një sistem parajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.
- dh) - Të kryejnë (ë) regjistrimet dhe dërgojnë (jë) të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- e) - Të raportojnë para asamblesë së përgjithëshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme më rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
- ë) - Të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithëshme në raste kur :

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda (3) muajve në vazhdim.
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër, **aktive**, të cilat kanë një vlerë më të lartë se **5% (pesëpërqind)** të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

5 Imelda Lika


Nëse Asambleja e Përgjithëshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithëshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme (thjeshtë).

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 15

PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht, sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet :

1. a) Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe statut në mirëbesim dhe në interesin më mirë të shoqërisë në tërsi duke i kushtuar vemendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdus.

b) Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita.

c) Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim.

c) Të parandalojë dhe të mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundëshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë.

d) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërbleje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që (ai) ata apo personat e lidhur me (të) ta, kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme :

a) U kthen ortakëve kontributet.

b) U paguan ortakëve interesa apo dividentë.

c) U shpërndan aktivet e shoqërisë.

c) Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftesi paguese për të shlyer detyrimet.

d) Jep kredi

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët, individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

6 *Zmellor Lika*
S. G. Lika

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU I IV
NENI 16

VITI FINANCIAR

Viti finanziar i Shoqërisë fillon me **01 Janar** dhe përfundon me **31 Dhjetor**. Përjashtimisht, viti i **parë finanziar** fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllt me **31 Dhjetor**.

NENI 17

EKSPERTËT

Eksperti ka për detyrë që kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë, i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Nër përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor, si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU I V

PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHQËRISË

NENI 18

PRISHJA dhe LIKUIDIMI

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj.
- b) Me vendim të asamblesë së ortakëve
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit
- ç) Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 (dy) vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".
- d) Me vendim të gjykatës :

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, **duke caktuar 1** (një) ose disa likuidatorë **dhe shënuar** në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "**Shoqeri në likuidim e sipër**".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 19

RIORGANIZIMI I SHQËRISË, BASHKIMI-NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithëshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën e IX të Ligjit Nr.9901, datë 14.02.2012 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" në Republikën e Shqipërisë.

7 *Imelola Lika*


Administrator i shoqërisë do të jetë Znj. Imelda LIKA.

Modalitetet për ndryshimin e Administratorit/ve si dhe kompetencat rregullohen nga **Statuti i Shoqërisë dhe Ligji Nr 9901 Dt.14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".**

Ky Akt Themelimi është përpiluar në katër kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.

**THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE
BRAHIMI-13
Imelda LIKA**

Peshkopi, me 22.07.2019

Imelda Lika
79